

VENDIM
Nr.112, datë 4.11.2011

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SUBJEKTIT “AUTORITETI PORTUAL Durrës”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 5, pika 2 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.17, datë 6.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga subjekti “Autoriteti Portual Durrës” për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe vendimit nr.107, datë 10.12.2011, të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2011”, si më poshtë:

- Neni 4 germa “a” është plotësuar konform rregullores.
 - Neni 4 germa “b” është plotësuar konform rregullores.
 - Neni 4 germa “c” është plotësuar konform rregullores.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të klientit të kualifikuar subjektit “Autoriteti Portual Durrës”.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani